



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.361/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Bashkim Kaliqanaj, kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal në Istog nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 31.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL. Anr.361/2025 e datës 29.10.2025, parashtruar nga Bashkim Kaliqanaj, kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal në Istog nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 29.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Bashkim Kaliqanaj, kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal në Istog nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e dorëzuar në Postën e Kosovës me datën 27.10.2025 në të cilën pretendon se pas shpalljes së rezultateve nga KQZ-ja dhe pas verifikimit final të votave në disa vendvotime ka dyshime të mëdhaja se kanë ndodhur keqpërdorime dhe devijime të votave për kandidat në qendrat 0601 “Haxhi Zeka”-Istog, 0602 “Trepça”- Banjë e Pejës, 0603 “Fan Noli”- Dobrushë, 0610 “Bajram Curri”- Muzhevinë, 0618 “Bajram Curri”- Cërçë, 0619 “ Zymer Zeka”- Kaliqan. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se dyshimet bazohen në bisedat e drejtpërdrejta me votues të cilët janë të gatshëm të nënshkruajnë deklaratë nën betim se kanë votuar për të si kandidat dhe njëkohësisht të vijnë të dëshmojnë qoftë nevoja drejtpërdrejt kudo qoftë së vota është dhënë por nuk figuron fare ose figurojnë me pak se deklarinimet.

Ankuesi thekson se deklaratat me shkrim nuk janë bashkangjitur në këtë ankesë për shkaqe të ruajtjes së privatësisë së votës edhe pse deklaruesit kanë dhënë autorizimin për përdorimin dhe bashkëngjitjen e tyre në ankesë me përgjegjësi të plotë dhe pa asnjë presion dhe se mund të bashkëngjiten nëse kërkohen. Andaj bazuar në këtë arsyetim, parashtruesi i ankesës kërkon

nga PZAP që të bëjë ri-verifikim dhe rinumërim të votave në këto qendra, duke hapur kutitë dhe duke verifikuar votë për votë çka ka ndodhur, me qëllim të respektimit të votës, ligjit dhe demokracisë.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Pala ankuese ndër të tjera pretendon se mungojnë votat e votuesve të cilët sipas tij kanë deklaruar se e kanë votuar. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, nuk mund të identifikohet mënyra e votimit të asnjë votuesi. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese e cila mbështet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave se kanë votuar për ta, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 par.1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

KQZ-ja pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Istogut, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 15.10.2025, në ora 22:00 ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 27.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, par.1 të LZP. Në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkangjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tyre.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallën nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Gjithashtu, KQZ njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga

QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve, ankesës të ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-së konstatoj se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në postë me datë 27.10.2025, ndërsa në PZAP ka arritur me dt.29.10.2025 ora 10:15 ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në numërim të votave, ndërsa sipas përgjigje nga KQZ dhe Provave të Bashkangjitura procesi i numërimit në Qendër Komunale është përmbyllur me datë 15.10.2025 në ora 22:00.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decitive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo kuptohet se ankesa janë dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara", ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që "Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR".*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, Bashkim Kaliqanaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të mungesës së votave, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi që ankesën e ankueses të hedhet si e pasafatshme, pasi që aktiviteti në QKN në komunën e Istogut është përmbyllur me datë 15.10.2025 ndërsa ankesa është paraqitur nëpërmjet postës me datë 27.10.2025, me çka vërtetohet se ankesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve, ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës PZAP, përkatësisht Paneli nuk i ka vlerësuar, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme PZAP, përkatësisht Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje të ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 105 paragraf 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.361/2025, datë 31.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.